


Raporti i parë për punën e Komisionit shtetëror për pengim të korrupsionit

(Mars 2019 - Dhjetor 2019)

Authorë: Martina Ilievska



Projekti “Monitorimi i suksesit të punës së Kimisionit Shtetëror për Mbrojtje nga Korrupsioni” është financuar nga Fondacioni Shoqëri e Hapur - Maqedoni. “Përmbajtja është përgjegjësi e vetme e autorëve dhe grantuesit dhe në asnjë mënyrë nuk mund të konsiderohet se i shpreh pikëpamjet dhe qëndrimet e Fondacionit Shoqëri e Hapur-Maqedoni”.

Përmbajtje

Rezyme	1
Komisioni shtetëror për pengim të korrupsionit	2
Analizë e rezultateve	3
Analizë e të dhënave që janë marrë me qasje në informacionet me karakter publik	13
Qasje metodologjike	19
Rezyme e shkurtër	23
Bibliografi	24

Impressum

Titull: Raporti i parë për punën e Komisionit shtetëror
për pengim të korrupsionit

Botues: Institute for Democracy
„Societas Civilis“ – Skopje

Authorë: Martina Ilievska

Përkthim: Mustafa Peza

Dizajni: Dejan Kuzmanovski

Ky publikim është i disponueshëm në:
<http://www.idscs.org.mk>

CIP - Каталогизација во публикација

Национална и универзитетска библиотека "Св. Климент Охридски", Скопје

35.072.2:343.352(497.7)"2019*03/*09"(047.31)\ \ .

ILIEVSKA, Martina

Raporti i parë për punën e Komisionit shtetëror për pengim të
korrupsionit / Martina Ilievska. - Shkup : Institutit për demokraci
Societas Civilis, 2020. - 28 str. : граф. прикази, табели ; 30 см

Фусноти кон текстот. - Библиографија: стр. 28

ISBN 978-608-4775-51-5

а) Државна комисија за спречување корупција - Транспарентност -
Македонија - 2019*03/*09 - Истражувања
COBISS.MK-ID 112033290

Rezyme

Si qëllim kryesor për monitorimin e punës së Komisionit shtetëror për pengim të korrupsionit (KSHPK) është përcjellje e aktiviteteve të KSHPK dhe vendimet e miratuara për lëndët e hapura për dyshime të ndryshme për korrupsion dhe/edhe konflikt të interesave. Raporti mbështetet në analizën e dokumenteve të cilat janë të qasshme publikisht në ueb – faqen e KSHPK. Në këtë pjesë janë dhënë rezultatet që burojnë nga qasja hulumtuese.

Monitorimi i aktiviteteve të Komisionit shtetëror për mbrojtje nga korrupsioni është bërë në bazë të metodologjisë, i përpiluar në punëtorinë dyditore të Platformës për luftë kundër korrupsionit. Lëndë e analizës janë vendimet e miratuara nga Komisioni shtetëror për pengim të korrupsionit në periudhën prej marsit të vitit 2019 deri në shtator të vitit 2019 dhe përgjigje në kërkesat të dërguara në KSHPK. Numri i tërësishëm i vendimeve të miratuara dhe të analizuar të KSHPK është N=273, të miratuara në 22 seanca. Për marrje të informacioneve rrënjësore në shtator të vitit 2019 ishin dërguar kërkesa për qasje në informacione me karakter publik dhe institucioni u përgjigj në afatin e paraparë ligjor, përgjigjet e të cilave janë pjesë e analizës.

Komisioni mund ta mbyll procedurën pas miratimit të vendimit në pajtim me të dhënat që janë marrë gjatë procedurës ose, ndërkaq, ta vazhdojë me procedurën pas konstatimit të shkeljes të ndonjëres nga dispozitat të Ligjit për pengim të korrupsionit dhe konfliktit të interesave. Pothuajse **një e katërta e vendimeve (65) përmbajnë dispozitë për vazhdim të procedurave, ndërsa pjesa më e madhe (208) janë ndalu për shkaqe të ndryshme.** Për kontekstualizimin e gjetjeve e rëndësishme është e dhëna se për vazhdim të procedurës (ngritje të procedurës para institucioneve të tjera ose lëshimi i fletë-urdhëresës kundërvajtëse pagesore) më së shumti është kërkuar

në fushën arsim dhe vetëqeverisje lokale. Përballë kësaj të dhëne, për një të pestën e rasteve, Komisioni ka vendosur se nuk ka të dhëna të mjaftueshme ose elemente për ngritje të procedurës para organeve të tjera, pas së cilës me vendim e mbyll procedurën.

Kohëzgjatja mesatare nga fillimi i procedurës deri në miratimin e vendimit të KSHPK është 2 muaj e 18 ditë. Nëse merret parasysh se procesi nënkupton grumbullim të të dhënave nga institucione relevante, shqyrtimi i të dhënave dhe miratimi i vendimit, kjo e vë në pah veprimin relativisht të shpejtë të komisionit dhe bashkëpunim të mirë me institucionet e tjera nga të cilat duhet të merren informacionet, e nevojshme në procedurën.

Kur bëhet fjalë për llojet e shkeljeve që janë parashtruar në fletë-paraqitjet, **KSHPK më së shumti ka sjellë vendime për procedura për punësim dhe kontroll të interesit.** Përkatësisht, paraqitjet kanë qenë për shkelje të të drejtave nga marrëdhënia e punës dhe procedurat për punësim, 42%. Procedurat të cilat janë të strukturuara në kontroll të interesave dhe të pronës, janë edhe procedura për kontroll të listave anketuese për gjendjen pronësore, e njëkohësisht janë edhe procedura për kontroll të listave anketuese në të cilat ka të shquptuara numër më të madh të urdhëresave kundërvajtëse.

Në sektorët e arsimit dhe (dhënësve të) shërbimeve publike KSHPK në këtë periudhë kanë sjellë më shumë vendime, ndërsa, ndërkaq, asnjë nga vendimet e miratuara në këtë periudhë nuk është miratuar për procedurë të udhëhequr në fushat e Koncesioneve – dhënie e koncesioneve për minerale dhe lëndë të para, përkatësisht procedura me dyshime për koncesion për ndarje të koncesioneve për eksploitim të lëndëve të para dhe/ose ndërmarrjeve të cilat eksploatojnë të parat.

Komisioni shtetëror për pengim të korrupsionit

Rregullimi i kompetencave të Komisionit shtetëror për pengim të korrupsionit, në thelb, është bërë në *Ligjin për pengim të korrupsionit dhe të konfliktit të interesave* të miratuar në janar të vitit 2019. Ligji e integroi pengimin e korrupsionit me pengimin e konfliktit të interesave, të cilat para kësaj ishin objekt i rregullimit të ligjeve të veçanta. Komisioni shtetëror për pengim të korrupsionit me miratimin e ligjit ka kompetenca të zgjeruara në raport me pengimin e korrupsionit. Në mënyrë shtesë, me ndryshimet e ligjit u bënë edhe ndryshime në kushtet dhe procedurën për zgjedhje të KSHPK.

Komisioni shtetëror për pengim të korrupsionit është autonom dhe i pavarur në kryerjen e punëve të përcaktuara me ligj dhe ka cilësi të personit juridik, i përbërë nga kryetar dhe gjashtë anëtarë. Komisioni shtetëror ka sekretariat me të cilin udhëheq sekretar i përgjithshëm, si dhe shërbim profesional e cila i zbaton punët administrative në kompetencë të Komisionit shtetëror. Kryetari dhe anëtarët e Komisionit shtetëror zgjedhjen në shpallje publike të cilën e shpall Kuvendi i Republikës së Maqedonisë

dhe në pajtim me këtë ligj, emërohen nga Kuvendi i Republikës së Maqedonisë për periudhë prej pesë vitesh, pa të drejtë për zgjedhje të sërishme.¹

KSHPK ka kompetenca të ndërlidhura me procesin e krijimit të politikave, përcjelljes dhe mbikëqyrjes, si dhe bashkëpunim me organe të tjera shtetërore me qëllim të pengimit të korrupsionit. Autorizimet që i ka janë: të ngre iniciativa për nisje të procedurës para organeve kompetente për shkarkim, vendosje, ndërrim ose zbatim të masave të tjera të tjera të përgjegjësisë, si dhe procedurë për përndjekje penale të personave të zgjedhur, të emëruar ose zyrtar në organet e administratës publike.²

Me miratimin e ligjit të ri, pushoi mandati i anëtarëve të Komisionit shtetëror të zgjedhur paraprakisht, ndërsa anëtarët e ri të komisionit u zgjedhën më 8 shkurt të vitit 2019.

¹ Ligj për pengim të korrupsionit dhe konfliktit të interesave, Numri i Gazetës zyrtare: 12/2019 (neni 9 dhe 10)

² Kocevski, G. (2019). Towards accountable and transparent public administration by means of functional oversight institutions. Foundation Open Society – Macedonia.

Analizë e rezultateve

Numri më i madh i vendimeve janë nga fusha e shërbimeve publike dhe të arsimit

Vendimet të cilat i ka sjellë KSHPK në periudhën që është objekt i analizës, më së shumti kanë të bëjnë me lëndët të cilat nga fusha e shërbimeve publike 28% dhe arsimit 24%. Vendimet që janë të analizuara nga fusha e shërbimeve publike kanë të bëjnë me procedurat që iniciuara nën dyshim se ka veprime joligjore në institucionet që janë dhënë të shërbimeve publike, ndërsa të njëjtat nuk janë të përfshira në fushat tjera. Rastet të cilat janë të paraqitura nën fushën arsim kanë të bëjnë me procedura të cilat janë udhëhequr për të punësuar dhe bartës të funksioneve udhëheqëse në institucionet arsimore nga të gjitha nivelet dhe procedura të cilat janë zhvilluar në institucionet arsimore (punësim, ndërprerja e marrëdhënies së punës e ngj.).


Asnjë nga vendimet e miratuara në këtë periudhë nuk është për procedurë të udhëhequr në fushat Koncesione – ndarje të koncesioneve dhe mineraleve dhe lëndëve të para, përkatësisht procedura me dyshime për korrupsion për ndarje të koncesioneve për eksploitim të lëndëve të para, dhe/ose ndërmarrjeve të cilat eksploatojnë lëndë të para. Pjesa më e madhe të procedurave (208) janë ndalur për shkaqe të ndryshme, por 65 vazhdojnë

në procedurë të mëtejme. Vazhdimi i procedurës më shumë është kërkuar në fushën arsim dhe vetëqeverisje lokale. Nga procedurat e vazhduara 45% janë nga fusha arsim, ndërsa 35% nga vetëqeverisja lokale. Pothuajse të gjitha nga procedurat e vazhduara në këto dy fusha kanë të bëjnë me kontroll të pronës dhe procedura vazhdohet me lëshimin e urdhër pagesave kundërvajtëse në para ose me procedurë të barazimit. Procedurat janë filluar për shkak të mos-përmbylljes së obligimit për plotësim dhe dërgim të fletës anketuese me regjistrim të detajuar të pronës.

Procedurat të cilat janë të mbyllura në vendimet e KSHPK pa vazhdimin e mëtejme para institucioneve të tjera ose pa shqiptimin e masës nga KSHPK, më së shumti janë nga fusha e shërbimeve të tjera publike 33%. Procedurat e mbyllura nga fusha e shërbimeve publike kur do të krahasohen me llojin e shkeljes, rezulton se në numër më të madh janë të llojit të punësimit, përkatësisht procedura për marrëdhëniet e punës.

Pasqyrë e detajuar, sipas fushave të vendimeve të miratuara nga KSHPK të cilat janë objekt i analizës, është prezantuar në grafikun 1. ►

► **Grafiku 1. Fusha të vendimeve të miratuara të KSHPK**



Urdhër pagesa kundërvajtëse për fletë anketuese të pa parashtruara për gjendje të pronës


Nëse krahasohen vendimet e miratuara në fushat e ndryshme me llojin e shkëljes e cila është përcaktuar, konstatohet se numri më i madh i procedurave kanë qenë të ndërlidhura me llokin punësim dhe procedura për punësim, e më së paku për ndikësë mbi regullativën. Vendimet e ndërlidhura me punësimin më së shumti janë në fushën e gjyqësisë - 56% dhe në fushën organe për zbatimin e ligjit, 73%.

Shmangie më të madhe ka në fushën e arsimit, ku numri më i madh i procedurave kanë qenë të llojit të kontrollit të interesave dhe të pronës, përkatësisht kanë të bëjnë me kontrollimin e fletëve obliguese anketuese për gjendjen e pronës të cilat duhet dorëzojnë të punësuarit në funksionet udhëheqëse në institucionet arsimore, 18% nga numri i tërësishëm i procedurave dhe 71% nga procedurat në fushën arsim.


Në pjesën më të madhe të procedurave të llojit të kontrollit të pronës kanë vazhduar me lëshimin e urdhërësave kundërvajtëse pagesore, procedurë për barazim të llojit të kontrollit të pronës e cila i parapraprin procedurës kundërvajtëse. Numri i urdhërësave kundërvajtëse pagesor që janë theksuar në vendimet e KSHPK, nuk përkohet me të dhënat që janë marrë përmes qasjes në informacionet me karakter publik. Në të vërtetë, sipas vendimeve të publikuara publikisht në ueb-faqen e KSHPK janë lëshuar **51** pagesa të tilla kundërvajtëse, ndërsa, ndërkaq, me shkrim KSHPK u përgjigj se janë lëshuar **68** fletë urdhëresa pagesore.

Pasqyrë e detajuar sipas fushës dhe llojit të vendimeve të miratuara nga KSHPK të cilat janë lëndë e analizës është dhënë në grafikun 2 dhe grafikun 3.

Grafiku 2. Pasqyrë sipas fushës dhe llojit të vendimeve të miratuara nga KSHPK



Grafiku 3. Pasqyrë sipas llojit dhe fushës së vendimeve të miratuara nga KSHPK



42% nga vendimet e miratuara kanë të bëjnë me procedura të ndërlidhura me punësimin ose marrëdhënie të punës


KSHPK në periudhën e analizuar, m[shumë vendime kanë sjellë për procedura të llojit të punësimit dhe llojit të kontrollit të interesit, e më së paku ka vendosur për raste të ndërlidhura me llojin e ndikesës së rregullativës.

pothuajse dy të tretat nga procedurat për të cilat janë miratuar vendime në periudhën e analizës janë të ndërlidhura me procedura për punësim

dhe/ose marrëdhëniet e punës (42%) dhe kontroll të interesave dhe të pronës – kontroll i rregullt i KSHPK të listave anketuese për gjendjen pronësore të bartësve të funksioneve publike (27%).

Pasqyrë e detajuar sipas llojit të shkeljeve të miratuara nga KSHPK të cilat janë lëndë e analizës janë dhënë në grafikun 4.

Grafiku 4. Pasqyrë sipas llojit të shkeljeve në vendimet e miratuara nga KSHPK



Një vërejtje publike është shqiptuar në periudhën prej shtatë muajsh

Komisioni shtetëror për pengim të korrupsionit në një të pestën e rasteve ka vendosur se nuk ka të dhëna të mjaftueshme ose elemente për ngritje të procedurës para organeve të tjera pas së cilës e mbyll procedurën dhe nuk ngrit procedurë para organeve të tjera kompetente. Përballë kësaj të dhëne vetëm në 4% nga procedurat komisioni ka vendosur të fillojë iniciativë për procedurë të mëtejme para institucioneve të tjera.


KSHPK në një të pestën vendimeve konkludo se nuk ka korrupsion ose konflikt të interesave, pas

së cilës i mbyll procedurat.

Masat e mëtejme të cilat i shqipton KSHPK në vendimet janë masë kundërvajtëse dhe është lëshuar urdhëresë kundërvajtëse pagesore 19.9%, ndërsa vetëm në një rast është shqiptuar masë vërejtje publike.

Pasqyrë e detajuar sipas statusit të vendimit të miratuar në vendimet e miratuara nga KSHPK të cilat janë lëndë e analizës është dhënë në grafikun 5.

Grafiku 5. Pasqyrë sipas statusit të vendimit të miratuar në vendimet e miratuara nga KSHPK



Një pjesë të madhe të procedurave KSHPK i fillon me iniciativë të vetën


Pozitive janë të dhënat se më tepër se një e treta e procedurave të filluara nga KSHPK, me iniciativë të vetë 26% dhe në sajë të detyrës zyrtare 7% si dhe me zë të ardhur nga njohuritë e fituara nga mediet 12%. Numri më i madh i procedurave janë filluar në sajë të iniciativës së ngritur nga parashtrues i njohur ose nga një grup i parashtruesve 28%, ndërsa një pjesë e vogël janë ngritur pas paraqitjes së parashtruar nga parashtruesi i panjohur 5% dhe të parashtruara me postë elektronike 2%.

Gjatë krahasimit të të dhënave sipas iniciatorit

të procedurës dhe vazhdimet të statusit të vendimeve, numri më i madh i vendimeve në të cilat është konstatuar se procedura duhet të vazhdojë janë filluar me iniciativë vetanake të KSHPK, 72%, ndërsa, ndërkaq, numri më i madh i procedurave të ndalura janë të iniciuara nga parashtrues të njohur 33%.

Pasqyrë e detajuar sipas iniciatorit të procedurave të KSHPK të cilat janë objekt i analizës, është dhënë në grafikun 6.

Grafiku 6. Pasqyrë sipas iniciatorit të procedurave të KSHPK



KSHPK ka konstatuar korrupsion ose konflikt të interesave në 4% të vendimeve

Gjatë inicimit të procedurave që kanë të bëjnë me partitë politike KSHPK në më tepër se gjysmën vendos se nuk janë të konfirmuara gjetjet e theksuara në paraqitjen ose i hedh poshtë gjetjet.

Vetëm në 4% nga paraqitjet e parashtruara konstaton se ekziston korrupsion ose konflikt të interesave dhe inicion procedurë të mëtejme. Për vendimet të cilat kanë nga fusha e gjyqësisë më shpesh vendos se nuk ka korrupsion ose konflikt të interesave dhe se komisioni nuk është kompetent dhe përjashtohet nga procedim të mëtejme.

Procedurat të cilat janë të ndërlidhura me shëndetësinë, ndërtimtarinë dhe ambientin

jetësor dhe biznesi dhe financat më shpesh janë të mbyllura për shkak se KSHPK konsideron se nuk ka të dhëna të mjaftueshme për vazhdimin e procedurës.

Numri më i madh i procedurave kundërvajtëse janë shqiptuar në fushat e vetëqeverisjes lokale dhe arsimin dhe të njëjtat kanë të bëjnë me paraqitjen jo në kohë të fletëve anketuese për dëshmimin e gjendjes së pronës të bartësve të funksioneve publike.

Pasqyrë e detajuar sipas Statusit të procedurës të miratuar me vendimin në pajtim me fushat në të cilat është theksuar dyshim për shkelje në vendimet e KSHPK të cilat janë lëndë e analizës të dhëna në tabelën 2. ▶

Tabela 2. Pasqyrë sipas Statusit të procedurës të miratuar të miratuar në pajtim me fushat në të cilat është theksuar dyshim për shkelje në vendimet e KSHPK.			STATUS I VENDIMIT											
			NUK KA TË DHËNA TË MJAFTUESHME PER PROCEDURE	E HEDHUR POSHTË/E REFUZUAR	E KONFIRMUAR/E MIRATUAR	NDRYSHIM I GJENDJES FAKTIKE	NUK KA KOMPETENCË	NUK KA KORRUPSION/ KONFLIKT TË INTERESAVE	TË PABAZA/TË PA KONFIRMUARA	KUNDËRVAJTËSE	E PABAZË	VËREJTJE PUBLIKE	PA BAZË	EVJETËRSUAR
FUSHË	Parti politike	% fushë	23%	32%	4.5%		4.5%	4.5%	32%					
		% nga gjithsej	2%	3%	0.4%		0.4%	0.4%	3%					
	Gjyqësi	% fushë	5%	21%		5%	32%	37%						
		% nga gjithsej	0.4%	1.5%		0.4%	2.2%	2.6%						
	Shëndetësi	% fushë	37.5%			12.5%	12.5%	12.5%		12.5%	12.5%			
		% nga gjithsej	1%			0.4%	0.4%	0.4%		0.4%	0.4%			
	Ndërtimtari dhe ambient jetësor	% fushë	33%	33%				33%						
		% nga gjithsej	0.4%	0.4%				0.4%						
	Biznes dhe financa	% fushë	44%	33%			11%						11%	
		% nga gjithsej	1.5%	1%			0.4%						0.4%	
	Medie	% fushë		50%				50%						
		% nga gjithsej		0.4%				0.4%						
	Organe për zbatim të ligjit	% fushë	27%	18%	9%			45.5%						
		% nga gjithsej	1%	1%	0.4%			2%						
	Energjetikë	% fushë							100%					
		% nga gjithsej							0.4%					
	Arsim	% fushë	15%	3%	1.5%		1.5%	17%	3%	42%				17%
		% nga gjithsej	4%	1%	0.4%		0.4%	4%	1%	10%				4%
	Koncesione	% fushë												
		% nga gjithsej												
	Bujqësi	% fushë		50%	50%									
		% nga gjithsej		0.4%	0.4%									
	Minerale dhe lëndë të para	% fushë												
		% nga gjithsej												
	Sport	% fushë	33%			33%	33%							
		% nga gjithsej	0.4%			0.4%	0.4%							
	Shërbime publike	% fushë	26%	7%		21%	3%	22%	5%	12%			4%	
		% nga gjithsej	7%	2%		6%	1%	6%	1.5%	3%			1%	
	Vetëqeverisje lokale	% fushë	6%	12.5%	12.5%	17%	2%	15%		33%		2%		
		% nga gjithsej	1%	2%	2%	3%	0.4%	3%		6%		0.4%		

KSHPK i nevojiten mesatarisht dy muaj nga fillimi i procedurës deri në miratimin e vendimit

Periodha e miratimit të vendimit nga ana e KSHPK, në periudhën nga marsi deri te shtatori, mesatarisht është 2 muaj e 18 ditë pas parashtrimit të procedurës nga parashtruesi deri në sjelljen e vendimit.

Pjesa më e madhe e vendimeve janë miratuar pas kalimit të një muaji pas parashtrimit të procedurës. Numri maksimal i ditëve që i janë nevojitur KSHPK janë 219 për procedurë për dyshime për keqpërdorime të bëra gjatë shpërndarjes së mjeteve buxhetore për financim të programit nga fusha e kulturës nga Ministria e kulturës e cila është ndërprerë sepse nuk ka të dhëna për procedurë të mëtejme. Numri minimal prej 3 ditëve është për procedura të iniciuara nga partitë politike gjatë periudhës zgjedhore dhe fushata zgjedhore në vitin 2019.


Komisioni më shumë kohë i është nevojitur që të

vendos për procedurat të cilat kanë qenë nën kontroll të interesave dhe pronës e punësimit për të cilët kanë qenë të nevojshëm rreth tre muaj për tu marrë të gjitha informacionet për të njëjtat.

Nëse shqyrtohet periodha kohore për miratim të vendimit e cila është e vazhduar në procedurën e mëtejme dhe e mbyllur nga KSHPK nuk ka dallim të rëndësishëm në vlerën mesatare të kohëzgjatjes. Periodha nga fillimi i procedurës deri në miratimin e vendimit për mbylljen e të njëjtave, komisionit ka pasur nevojë 2 muaj e 18 ditë për të sjellë vendim, ndërsa për vendimet të cilat janë të vazhduara me procedurë të mëtejme 2 muaj e 20 ditë.

Pasqyrë e detajuar të ditëve për miratim të vendimit nga KSHPK të cilat janë objekt i analizës është dhënë në grafikun 7.

Grafiku 7. Pasqyrë e ditëve të miratimit të vendimeve nga KSHPK



Pasqyrë e detajuar krahasuar me llojin e shkëljes dhe kohëzgjatjen e procedurës së vendimeve të

miratuara nga KSHPK që janë objekt i analizës janë dhënë në tabelën 3.

Tabela 3. Pasqyrim në krahasim me llojin e shkëljes dhe kohëzgjatja e procedurës së vendimeve të miratuara nga KSHPK.			GJITHSEJ DITË						
			3-29	30-59	60-89	90-119	120-149	150-179	180-219
LLOJ	Financa publike	% fushë	6%	53%	13%	9%	9%	0%	9%
		% nga gjithsej	1%	7%	2%	1%	1%	0%	1%
	Mbikëqyrje	% fushë	32%	41%	5%	9%	5%	5%	5%
		% nga gjithsej	3%	4%	0%	1%	0%	0%	0%
	Punësim	% fushë	6%	30%	36%	11%	9%	6%	1%
		% nga gjithsej	3%	13%	15%	5%	4%	3%	0%
	Kontrolli i intereseve dhe pronës	% fushë	6%	21%	40%	9%	1%	3%	20%
		% nga gjithsej	2%	6%	11%	2%	0%	1%	5%
	Ndikesë mbi regullativën	% fushë	25%	50%	0%	0%	25%	0%	0%
		% nga gjithsej	0%	1%	0%	0%	0%	0%	0%
	Kumulim të funksioneve	% fushë	0%	55%	5%	0%	35%	5%	0%
		% nga gjithsej	0%	4%	0%	0%	3%	0%	0%

Analizë e të dhënave të fituara me qasje në informacionet me karakter publik

Puna e Komisionit shtetëror bazohet mbi ligjin për mbrojtje nga korrupsioni dhe konflikt të interesave ku janë të përshkruara dispozitat për zgjedhje të anëtarëve të komisionit, fushëveprimi i punës dhe funksionimi i brendshëm. Gjatë periudhës zgjedhore KSHPK ka funksion aktiv për përcjellje të proceseve zgjedhore, gjatë së cilës vepron në pajtim me Kodin zgjedhor.

Për tu parë në mënyrë më thelbësore puna e tij, Komisionit shtetëror për pengim të korrupsionit ju

dërguan 13 kërkesa për qasje në informacione me karakter publik gjatë muajit shtator, në të cilat institucioni u përgjigj për të gjitha në afatin e paraparë me ligj. Pyetjet e dërguara KSHPK kishin të bëjnë me marrje të të dhënave për numrin e procedurave të filluara mbi baza të ndryshme, vazhdimin e procedurave dhe shqiptimin e masave, në pajtim me Ligjin për pengim të korrupsionit dhe të konfliktit të interesave dhe Kodin zgjedhor. ►

► **Korrupsion:**

Në pajtim me definicionet në Ligjin për mbrojtje nga korrupsioni dhe konflikti i interesave, korrupsioni është i definuar si korrupsion pasiv dhe aktiv.

“Korrupsion pasiv” - veprim i qëllimshëm i personit zyrtar i cili drejtpërdrejtë ose përmes ndërmjetësit, kërkon ose pranon përfitim të çfarë do qoftë lloji, për vete ose për person të tretë, ose pranon premtim për përfitim të tillë, me qëllim që të veprojë ose të përmbahet nga veprimi në pajtim me obligimet e veta ose ti kryejë kompetencat e tija në kundërshtim me obligimet zyrtare.

“Korrupsion aktiv” - veprim i qëllimshëm i cilit do qoftë person i cili në mënyrë të drejtpërdrejtë ose përmes ndërmjetësit, premton ose jep përfitim të çfarë do qoftë lloji për një person zyrtar, për atë ose për person të tretë, me qëllim që të veprojë ose të përmbahet nga veprimi në pajtim me obligimet e tija ose ti kryejë kompetencat e tija në kundërshtim me obligimet zyrtare.” (Ligj për pengim të korrupsionit dhe konfliktit të interesave, neni 2).

E dhëna që është marrë pas kërkesës së dërguar KSHPK për qasje në informacione me karakter publik thotë:

“Na dërgoni informacion për numrin e lëndëve të formuara për shkak të dyshimit për ekzistim të korrupsionit në periudhën nga janari deri në tetor të vitit 2019. Për sa nga lëndët është sjell vendim dhe për sa nga lëndët ende zbatohet procedurë?”

Është dërguar përgjigja vijuese:

*“Komisioni shtetëror për pengim të korrupsionit, në pajtim me dispozitat e Ligjit për pengim të korrupsionit dhe konfliktit të interesave në periudhën nga janari i vitit 2019, përfundimisht me datën 14.10.2019 ka formuar **592** lëndë për shkak të dyshimit për ekzistimin e korrupsionit. Nga lëndët në përgjithësi të formuara në këtë periudhë janë sjellë gjithsej 77 vendime”.*

Përgjigje e KSHPK në kërkesë për informacione me karakter publik.

Konflikt i interesit:

Ligji për pengim të korrupsionit dhe konfliktit të interesave definon **konflikt të interesave** si gjendje në të cilën personi zyrtar (të gjithë personat të zgjedhur ose të emëruar në sektorin publik) ka interes privat që ndikon ose mund të ndikojë mbi ushtrimin e paanshëm të autorizimeve të tija publike ose obligimeve zyrtare.

Gjatë vazhdës së punës personi zyrtar është i obliguar të ketë kujdes në konfliktin potencial të interesave dhe të ndërmarrë masa për shmangie të tij. Në rast të dyshimit për konflikt të interesave, personi zyrtar është i obliguar të kërkojë mendim nga Komisioni shtetëror dhe të ndërmarrë masa të nevojshme për ta penguar ndikesën mbi interesin e tij privat. (Ligji për pengim të korrupsionit dhe konfliktit të interesave, neni 2).

E dhëna që është marrë pas kërkesës së dërguar KSHPK për qasje në informacione me karakter publik thotë:

"Na dërgoni informacion për numrin e lëndëve të formuara për shkak të përcaktimit të ekzistimit të konfliktit të interesave, në periudhën nga janari deri në tetor të vitit 2019".

Nga KSHPK është marrë përgjigja vijuese:

*"Komisioni shtetëror për pengim të korrupsionit, në pajtim me dispozitat e Ligjit për pengim të korrupsionit dhe konfliktit të interesave në periudhën nga janari i vitit 2019, përfundimisht me datën 14.10.2019 ka formuar gjithsej **362** lëndë për shkak të përcaktimit të **konfliktit të interesave**".*

Përgjigje e KSHPK në kërkesë për informacione me karakter publik.

Parregullsi në periudhën zgjedhore:

KSHPK ka rol aktiv në procesin zgjedhor dhe procedon në pajtim me Ligjin për pengim të korrupsionit dhe të konfliktit të interesave, kapitulli IV – Pengimi i korrupsionit në politikën dhe Kodi zgjedhor.

Në pajtim me kodin zgjedhor nga dita e miratimit të vendimit për shpallje të zgjedhjeve deri në përfundimin e zgjedhjes nuk mund të disponohet me mjetet buxhetore të RMV, mjete të buxheteve të komunave dhe të qytetit të Shkupit, nga fonde publike dhe mjete të ndërmarrjeve publike dhe institucione publike ose persona juridik të cilët disponojnë me kapital shtetëror. (Kodi zgjedhor, neni 8a).

Në mënyrë shtesë neni 8 b kryerje dhe përpjekje për kryerje të presionit të votuesve ose pjesëtarëve të familjeve të tyre ose personave të afërt me ata, si dhe shfrytëzim të pronës së luajtshme ose të paluajtshme për nevojat e fushatës zgjedhore. (Kodi zgjedhor, neni 8 b).

Zgjedhjet në vitin 2019, janë shpallur me Vendim nga Presidenti i Kuvendit të RMV më 07.09.2019, ndërsa janë mbajtur më 21 prill (afati parë zgjedhor) dhe 5 maj (afati i dytë zgjedhor). Procesi zgjedhor është i ndërlidhur me Zgjedhje të Presidentit të Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe zgjidhje të parakohshme për kryetarë të Ohrit, Novo Sellës, Dibrës.

Për marrje të të dhënës nga KSHPK për numrin e parashtresave që janë marrë u dërgua kërkesë për qasje në informacione me karakter publik në KSHPK në të cilën është shënuar:

“Na dërgoni informacion për atë se sa është numri i parashtresave të parashtruara për mos-respektim të nenit 8 a he nenit 8 b nga Kodi zgjedhor, gjatë fushatës zgjedhore në vitin 2018”.

Nga KSHPK është marrë përgjigja vijuese:

“Komisionit shtetëror për pengim të korrupsionit, në pajtim me dispozitat për pengim të korrupsionit dhe konfliktit të interesave dhe dispozitat nga Kodi zgjedhor, gjatë fushatës zgjedhore të vitit 2019 për zgjedhje të presidentit të Republikës së Maqedonisë Veriore janë parashtruar gjithsej 22 parashtresa për mos-respektim të nenit 8 a dhe 8 b nga Kodi zgjedhor”.

Përgjigje e KSHPK në kërkesë për informacione me karakter publik.

Paraqitje e (ndryshimeve në) gjendjes pronësore dhe të interesave:

Personi i zgjedhur ose i emëruar dhe personi përgjegjës në ndërmarrjen publike ose person tjetër juridik që disponon me kapital shtetëror, në afat prej 30 ditë nga fillimi i funksionit është i obliguar të parashtojë deklaratë për gjendjen pronësore dhe për interesat.

Komisioni shtetëror mban regjistër të personave të zgjedhur dhe të emëruar, persona përgjegjës në ndërmarrje publike, institucione publike ose persona të tjerë juridik të cilët disponojnë me kapital shtetëror, ndërsa **të dhënat nga deklarata për gjendjen e pronës dhe interesat dhe interesat dhe paraqitja për ndryshim të gjendjes pronësore dhe interesat paraqesin informacione me karakter publik, përveç të dhënave të mbrojtura me ligj dhe publikohen në ueb-faqen e Komisionit shtetëror.** Nëse ka ndryshim në pronën, çdo person që disponon me kapital shtetëror në afat nga rritja e pronës së tij ose të pronës së anëtarit të familjes së tij, është i obliguar ta paraqesë ndryshimin në gjendjen pronësore dhe interesat në afat prej 30 ditësh. (Ligji për pengim të korrupsionit dhe konfliktit të interesave, neni 85).

Për marrje të të dhënave për kontroll që e ën KSHPK për gjendjen pronësore të personave të cilat disponojnë me kapital shtetëror, u dërguan dy kërkesa për qasje në informacionet me karakter publik të cilat kanë të bëjnë me numrin e fletëve të parashtruara anketuese dhe kërkesat e parashtruara për ngritje të procedurës kundërvajtëse kundër personave që nuk e kanë përmbushur obligimin për plotësim dhe dorëzim të fletushkës Anketuese

Nga KSHPK janë marrë përgjigjet vijuese:

*"Komisionit shtetëror për pengim të korrupsionit në periudhën nga janari, përfundimisht me datën 15.10.2019 janë dërguar **555 fletë anketuese** nga personat e zgjedhur ose emërtuar dhe nga persona përgjegjës në ndërmarrjet publike, institucionet publike dhe personat e tjera publik të cilët disponojnë me kapital shtetëror".*

*"Komisioni shtetëror për pengim të korrupsionit në periudhën nga janari, përfundimisht deri më datën 15.10.2019 ka parashtruar **7 kërkesa** për ngritje të **procedurës kundërvajtëse** për shkelje të bërë për shkak të mos-përmbushjes së obligimit për plotësim dhe parashtrim të fletës anketuese.*

*Në periudhën e vënë në pah, për shkelje të konstatuar për shkak të mos-përmbushjes të obligimit për plotësim dhe parashtrim të fletës Anketuese me përshkrim të detajuar të pronës, para se të parashtrohet kërkesë për procedurë kundërvajtëse, është udhëhequr procedurë për barazim me ç'rast janë lëshuar **68 fletë urdhëresa pagesore** në pajtim me nenin 114 paragrafi 3 nga Ligji për pengim të korrupsionit dhe konfliktit të interesave".*

Përgjigje e KSHPK në kërkesë për informacione me karakter publik.

Shqiptimi i masës vërejtje publike:

Nëse Komisioni shtetëror konstaton ekzistim i konfliktit të interesave, ai është i obliguar që për atë ta informojë personin zyrtar dhe të kërkojë nga ai që në afat prej 15 ditësh nga dërgimi i vendimit ta mënjojë konfliktin e interesave, nëse personi zyrtar nuk procedon sipas kërkesës së SHKPK kërkon procedurë për personin e emëruar. Masa vërejtje publike shqiptohet për person i cili është zgjedhur në zgjedhje të drejtpërdrejta. (Ligji për pengim të korrupsionit dhe konfliktit të interesave, neni 77)

E dhëna që është marrë pas kërkesës së dërguar KSHPK për qasje në informacione me karakter publik thotë:

“na dërgoni informacion për numrin e vendimeve të miratuara për shqiptimin e masës – vërejtje publike, në pajtim me dispozitat nga Ligji për pengim të korrupsionit dhe konfliktit të interesave, në periudhën nga janari deri në tetor të vitit 2019”.

Nga KSHPK është marrë përgjigja vijuese:

“Komisioni shtetëror për pengim të korrupsionit në pajtim me dispozitat të Ligjit për pengim të korrupsionit dhe të konfliktit të interesave në periudhën nga janari deri në tetor të vitit 2019 ka sjellë një vendim për shqiptim të masës - Vërejtje publike”.

Përgjigje e KSHPK në kërkesë për informacione me karakter publik.

Qasje metodologjike

Komisioni shtetëror për pengim të korrupsionit (KSHPK) paraqet trup parandalues, i cili ka funksion të pengojë të krijohet korrupsion, por edhe të iniciojë procedura për institucionet e tjera në sistemin e antikorrupsionit. *Me miratimin e Ligjit për pengim të korrupsionit dhe konfliktit të interesave*, që është i ri u ndërpre mandati i anëtarëve të Komisionit shtetëror të zgjedhur paraprakisht, ndërsa anëtarët e ri u zgjodhën më 8 shkurt të vitit 2019.

Kruciale është që të përcillet puna e përbërjes së re të KSHPK dhe bashkëpunimit të tyre me institucionet, në drejtim të zvogëlimit të korrupsionit në Republikën e Maqedonisë së Veriut. Bashkëpunimi i ndërsjellë i institucioneve është faktor i rëndësishëm për luftë afatgjate dhe të qëndrueshme kundër korrupsionit.

Vendimet e miratuara nga Komisioni shtetëror për pengim të korrupsionit janë bazë për monitorim të punës, në shtatë muajt e para nga zgjedhja e anëtarëve të ri dhe të kryetarit të komisionit.

Metodologjia e përcjelljes së aktiviteteve të KSHPK dhe përgjigjet e institucioneve, për të cilat ka lënë të hapura ose institucionet ku ato lëndë janë të dërguara është hartuar gjatë punëtorisë dyditore, në të cilën morën pjesë përfaqësues të organizatave që janë pjesë e Platformës për luftë kundër korrupsionit.

Të dhënat në të cilat mbështetet raporti janë të grumbulluara nga Komisioni shtetëror për pengim të korrupsionit dhe paraqesin informacione të qasshme publikisht dhe informacione të fituara me dërgim të kërkesave për qasje në informacione me karakter publik që i dërgohen KSHPK. Janë analizuar vendimet e miratuara nga KSHPK në periudhën nga marsi deri në shtator të vitit 2019 në 22 seanca të mbajtura dhe janë marrë përgjigje në kërkesa për qasje në informacione me karakter publik që janë marrë nga KSHPK e që janë të dërguara në shtator të vitit 2019.

Përshkrim i ekzemplarit të analizës:

Objekt i analizës janë vendimet e miratuara nga Komisioni shtetëror për pengim të korrupsionit në periudhën nga marsi i vitit 2019 deri në shtator të vitit 2019 dhe kërkesa për qasje në informacione me karakter publik deri te KSHPK. Numri i tërësishëm i vendimeve të analizuara të Komisionit shtetëror për pengim të korrupsionit është **N=273**.

Komisionit shtetëror për pengim të korrupsionit ishin të dërguara **13 kërkesa** për qasje në informacione me karakter publik gjatë shtatorit, e institucioni iu përgjigj të gjitha pyetjeve në afatin e paraparë me ligj dhe të njëjtat ishin objekt i analizës.

Përshkrim i variablave:

Vendimet janë të analizuara sipas fushë në të cilat ka pasur intenca për korrupsion ose konflikt të interesave, lloje të shkeljeve, statusi i procedurës (gjë e cila është vendosur nga KSHPK) dhe kush e ka

iniciuar procedurën para KSHPK dhe kohëzgjatja e tërë procedurës. Pasqyrë e variablave që janë objekt i analizës është dhënë në tabelat numër 4 deri në numër 7.

Tabela 4. Pasqyrë fusha të vendimeve të miratuara të KSHPK	Fusha të vendimeve të miratuara nga KSHPK
Gjyqësi	Gjykata, organe gjyqësore, prokuroria publike, avokati i popullit, avokatia publike.
Shëndetësi	Institucione shëndetësore, qendra klinike, Enti republikan për mbrojtje shëndetësore, Fondi i shëndetësisë e kështu me radhë.
Ndërtimtari dhe ambient jetësor	Kompani ndërtimore, menaxhimi me ambientin jetësor, ndikesë mbi ambientin jetësor, menaxhimi me mbeturinat dhe depozitë e të tjera, projekte infrastrukturore.
Biznes dhe financa	Kompani private, banka, sigurim.
Medie	Medie tradicionale dhe online-medie
Organe për zbatim të ligjit	Polici, doganë, policia financiare e kështu me radhë.
Energjetikë	Ndërmarrje publike dhe kompani private të cilat punojnë në prodhimtari, distribuim dhe furnizim me energji elektrike dhe ngrohëse
Arsim	Çerdhe, shkolla fillore, shkolla të mesme, institucione të arsimit të lartë
Koncesione	Marrëveshje për shfrytëzim të tokës shtetërore/komunale dhe/ose pronës
Bujqësi	Subvencione, Ministria e bujqësisë
Minerale dhe lëndë të para	Miniera, ndërmarrje të cilat eksploatojnë lëndë të para
Sport	Federata sportive, organizata sportive, agjenci për rini dhe sport
Shërbime publike	Ndërmarrje publike e kështu me radhë – të cilat nuk janë përfshirë me fushën paraprakisht të përmendur
Vetëqeverisje lokale	Komuna, këshilla komunale, kryetarë të komunave, BNJVL

Tabela 5. Pasqyrë e llojit të shkeljes e cila është përcaktuar në pajtim me vendimet e KSHPK	Lloji i shkeljes e cila është konstatuar në pajtim me vendimet që janë marrë nga KSHPK
Ndikesë mbi regullativën	Raste ku ndikohet mbi krijimin e rregullave, politikave ose standardeve me qëllim të realizimit të interesit privat.
Financa publike	Nënkuptohen raste ku me qëllim të realizimit të interesit privat keqpërdoren paratë publike përmes furnizimeve publike, subvencioneve e ngj.
Punësim	Nënkuptohen raste ku interesi privat realizohet përmes punësimit, si për shembull raste të klientelizmit, nepotizmit dhe patronage.
Mbikëqyrje	Nënkuptohen raste ku interesi privat realizohet përmes presionit mbi strukturave për mbikëqyrje ose keqpërdorimi i tyre sistematik, dobësim ose shlyerje.
Kumulim i funksioneve	Nënkuptohen raste ku një person ushtron ose është i caktuar në dy ose më tepër funksione.
Kontroll i interesave dhe pronës	Fletë anketuese, mos-parashtrim, jo të plota

Tabela 6. Pasqyrë status i vendimit të miratuar	Statusi i vendimit të miratuar
Nuk të dhëna të mjaftueshme	Nuk të dhëna dhe elemente të mjaftueshme për ngritje të procedurës para organeve të tjera
E hedhur poshtë / e refuzuar	Procedura të hedhura poshtë dhe/ose të refuzuara
E konfirmuar, e miratuar, procedurë e mëtejme	Ka konfirmim për shkelje të ligjit, lënda është në procedurë të mëtejme
Ndryshim i gjendjes faktike	Gjatë procedurës ka ndryshuar gjendja faktike, procedura është mbyllur
Nuk ka kompetencë	KSHPK nuk ka kompetencë të ndërmarrë masa
Nuk ka korrupsion/konflikt të interesit	Është konstatuar se nuk ka korrupsion ose konflikt të interesit
Të pabaza, të pakonfirmuara	Të pabaza ose të pakonfirmuara janë indiciet të cilat janë të theksuara në paraqitjen e parashtruar
Kundërvajtëse	Është shqiptuar masë, paraqitje kundërvajtëse dhe urdhëresë pagesore
I hedhur poshtë	Rasti është hedhur poshtë nga KSHPK
I pavlefshëm	Procedura është e pavlefshme
Vërejtje publike	Është shqiptuar masë vërejtje publike
S'ka lëndë	Është konstatuar se procedura nuk ka lëndë
Vjetërsim	Rasti është mbyllur për shkak të vjetërsimit të rastit
Ka indicie për korrupsion, por ka ndryshuar gjendja faktike	Ka indicie për korrupsion/konflikt të interesave, por procedura është ndërprerë për shkak të ndryshimit të gjendjes faktike gjatë procedurës

Tabela 7. Pasqyrë e inicimit të procedurës	Inicim i procedurës
Iniciativë vetanake	Procedura është filluar me iniciativë të KSHPK
Parashtrues anonim	Paraqitja është dërguar nga parashtrues anonim
Parashtrues i njohur	Paraqitja është dërguar nga parashtrues i njohur
Njohuri nga mediet	Procedura është filluar sipas zërit të dëgjuar nga mediet
Postë elektronike	Paraqitja është marrë përmes postës elektronike
Detyrë zyrtare	Procedura është filluar në sajë të detyrës zyrtare të KSHPK
Parashtrues i panjohur	Paraqitja është dërguar nga parashtrues i panjohur
Parti politike	Paraqitja është dërguar nga parti politike
Nuk ka informacione	Nuk ka informacione në vendimet se si është iniciuar procedura

Rezyme e shkurtër

Komisioni shtetëror për pengim të korrupsionit nga zgjedhja e anëtarëve të ri në shkurt të vitit 2019 deri në shtator të vitit 2019 ka mbajtur 22 seanca dhe ka sjellë 273 vendime në pajtim me *Ligjin për pengim të korrupsionit dhe konflikt të interesit*. Komisioni në periudhën e analizuar procedurat i ka udhëhequr mesatarisht 2 muaj e 18 ditë, që është periudhë nga parashtrimi i procedurës nga parashtruesi deri në miratimin e vendimit.

Një pjesë e madhe e procedurave janë filluar me iniciativë vetanake të KSHPK, në sajë të detyrës zyrtare ose në sajë të zërit të dëgjuar nga njohuritë e fituara nga mediet që paraqesin indikator pozitiv për punën e këtij institucioni.

Për pjesën më të madhe të procedurave (208) KSHPK vendos ti ndërpresë për shkaqe të ndryshme, ndërsa, ndërkaq, 65 janë vazhduar për procedurë

të mëtejme. Komisioni shtetëror për pengim të korrupsionit në një të pestën e rasteve ka vendosur se nuk ka shkaqe ose elemente të mjaftueshme për ngritje të procedurës para organeve të tjera pas së cilës e mbyll procedurën dhe nuk inicion procedurë para organeve të tjera kompetente.

Vendimet që i ka sjellë KSHPK në periudhën e cila është objekt e analizës më së shumti kanë të bëjnë me lëndë të cilat janë nga fusha e shërbimeve publike dhe arsimit. Kur bëhet fjalë për llojin e shkeljes e cila është theksuar në paraqitjet, KSHPK ka sjellë më shumë vendime për procedura për punësim dhe kontroll të interesit.

Bibliografi

Vendimet e Komisionit shtetëror për pengim të korrupsionit janë të qasshme në linkun vijues:

<https://www.dksk.mk/index.php?id=113>.

Ligji për pengim të korrupsionit dhe konflikti i interesave, Numri i Gazetës zyrtare: 12/2019

Kocevski, G. (2019). Towards accountable and transparent public administration by means of functional oversight institutions. Foundation Open Society – Macedonia.

Kosi zgjedhor, "Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 40/06, 136/08, 148/08, 155/08, 163/08, 44/11, 51/11, 142/12, 31/13, 34/13, 14/14, 30/14, 196/15, 35/16, 97/16, 99/16, 136/16, 142/16, 67/17, 125/17, 35/18, 99/18, 140/18, 208/18, 27/19 dhe "Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 98/19.

